

UDHËZIM
Nr. 45, datë 16.10.2014

**PËR NJË NDRYSHIM NË UDHËZIMIN NR. 33, DATË 19.9.2014 “PËR
PROCEDURAT E PRANIMIT, NË INSTITUCIONET E ARSIMIT TË LARTË PUBLIK
E PRIVAT NË VITIN AKADEMINË 2014-2015 TË STUDENTËVE QË
TRANSFEROJNË STUDIMET NGA INSTITUCIONET PRIVATE TË ARSIMIT TË
LARTË, TË CILAVE IU ËSHTË HEQUR LICENCA”**

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, ligjit nr. 9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, vendimit nr. 539, datë 6.8.2014 të Këshillit të Ministrave “Për heqjen e licencës disa institucioneve private të arsimit të lartë”,

UDHËZOJ:

I. Udhëzimi nr. 33, datë 19.9.2014 “Për procedurat e pranimit, në institucionet e arsimit të lartë publik e privat në vitin akademik 2014-2015 të studentëve që transferojnë studimet nga institucionet private të arsimit të lartë të cilave iu është hequr licenca” ndryshojnë si më poshtë:

1. Pika 7 e kreut IV të udhëzimit të ndryshojë si më poshtë:

“Nga data 29 shtator deri në orën 12 të datës 22 tetor 2014 nga ana e studentëve kryhet aplikimi me dokumente origjinale sipas (pikës 2 të këtij udhëzimi) për programet e studimit të ofruara nga fakulteti përkatës sipas listave të programeve të studimit të ekuivalentuara. Brenda datës 22 tetor 2014 IAL-të publike dërgojnë në MAS listat e aplikantëve, duke specifikuar kandidatët të cilët pas shqyrtimit të dosjeve rezultojnë me dosje të rregullta të shoqëruara me planin e veprimeve për ekuivalentimin e studimeve të kryera, si dhe i shpallin ato publikisht në vende të dukshme faqet *web* të IAL-së dhe media elektronike dhe të shkruara.

2. Pika 8 e kreut IV të udhëzimit të ndryshojë si më poshtë:

“Komisionet e vlerësimit dhe të ekuivalentimit të ngritur pranë IAL-ve publike kryejnë vlerësimin dhe ekuivalentimin e dosjeve të kandidatëve që rezultojnë të rregullta më qëllim ekuivalentimin e rezultateve individuale të secilit prej studentëve ndjekës të programeve përkatës të studimit në IAL-të private të cilave iu është hequr licenca deri në orën 12 të datës 24 tetor 2014. Ekuivalentimi individual bëhet duke u bazuar në ekuivalentimin paraprak për çdo program studimi.”

3. Pika 10 e kreut IV të udhëzimit të ndryshojë si më poshtë:

“Dekanatet e fakulteteve bazuar në vendimin e komisionit të vlerësimit dhe ekuivalentimit, shpallin, brenda datës 24 tetor 2014 të dhënat për çdo kandidat, kreditet e ekuivalentuara, detyrimet dhe lëndët e pashlyera, si dhe vitin në të cilin transferohen.”

4. Pika 11 e kreut IV të udhëzimit të ndryshojë si më poshtë:

“Në periudhën nga data 24 tetor 2014 deri në datën 29 tetor 2014 bëhet regjistrimi i studentëve pranë sekretarive mësimore të fakultetit përkatës dhe paguhet tarifa përkatëse. Shuma e derdhur nuk kthehet dhe në rastet kur kandidati largohet nga programi i studimit.

5. Pika 1 e kreut VI të udhëzimit të ndryshojë si më poshtë:

“Kandidatët aplikojnë pranë IAL-ve private nga data 25 shtator deri në datën 31 tetor 2014”.

6. Pika 4 e kreut të VI të udhëzimit të ndryshojë si më poshtë:

“Në IAL-të private aplikantët regjistrohen përfundimisht brenda datës 3 nëntor 2014”.

II. Ngarkohen për zbatimin e këtij udhëzimi Sekretari i Përgjithshëm, Drejtoria e Arsimit të Lartë dhe Shkencës në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit, Agjencia Publike e Arsimit të Lartë, Agjencia Kombëtare e Provimeve, si dhe institucionet publike dhe private të arsimit të lartë.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I ARSIMIT DHE SPORTIT
Lindita Nikolla